

BULETINI 2025



KOMUNA E LIPJANIT



SHTATOR

Kryetari Ahmeti nënshkruan Memorandum Bashkëpunimi me Rrjetin e Grave të Kosovës



Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, ka nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi me Rrjetin e Grave të Kosovës - RrGK, me qëllim të fuqizimit të Mekanizmit Koordinues Komunal Kundër Dhunës në Familje - MKKDhF.

Ky bashkëpunim synon rritjen e kapaciteteve institucionale dhe profesionale të Mekanizmit, përmes trajnimeve të specializuara, përpilimit të strategjive të zhvillimit, planeve të punës dhe planifikimeve buxhetore. Në kuadër të kësaj marrëveshjeje, parashihet mbështetje për krijimin e bashkëpunimeve ndërsektoriale dhe forcimin e rolit të institucioneve lokale në ofrimin e mbrojtjes së duhur për viktimat e dhunës me bazë gjinore. Nënshkrimi i këtij memorandumi konfirmon angazhimin e përbashkët për forcimin e mekanizmave institucionale dhe ofrimin e një mbështetjeje gjithëpërfshirëse, të qëndrueshme dhe efektive për adresimin dhe trajtimin e dhunës me bazë gjinore.



Kryetari Ahmeti ndan mirënjohje për tre sportistët e suksesshëm të Lipjanit



Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, priti në takim tre sportistë të dalluar në futsall, Festim Maqaj, Ermal Maqaj dhe Altin Bytyqi.

Gjatë takimit, Kryetari Ahmeti u dorëzoi mirënjohje sportistëve për sukseset e tyre në futsall, duke theksuar se puna dhe përkushtimi i tyre përbëjnë një frymëzim për të gjithë të rinjtë e komunës.

Festim Maqaj, Ermal Maqaj dhe Altin Bytyqi shprehën mirënjohje për pritjen dhe vlerësimin e Kryetarit, duke theksuar se ky nder u jep motiv shtesë për të synuar arritje edhe më të mëdha në të ardhmen.

Komuna e Lipjanit është krenare për sportistët e saj, të cilët kanë arritur suksese të shkëlqyera në turne të ndryshme të futsallit dhe futbollit, duke përfaqësuar me dinjitet Lipjanin në nivel lokal dhe ndërkombëtar.

Kryetari i Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti, në zyrën e tij ka pritur Komandantin e Komandës Regjionale – Lindje të KFOR-it Amerikan në Kampin “Bondsteel”, Major Kevin Dugas, të shoqëruar nga pjesëtarë të tjerë të KFOR-it dhe përfaqësues nga LTM të KFOR-it turk të vendosur në Lipjan



Gjatë këtij takimi, Kryetari Ahmeti dhe Major Kevin Dugas kanë biseduar rreth sigurisë në Komunën e Lipjanit, vizionit të së ardhmes, por edhe për punët të cilat janë duke u bërë në gjithë territorin e Komunës së Lipjanit, mundësi bashkëpunuese, si dhe çështje të tjera me rëndësi.

Me këtë rast, Kryetari Imri Ahmeti ka vlerësuar lart bashkëpunimin e shkëlqyeshëm ndërmjet komunës dhe KFOR-it, si dhe shprehur gatishmërinë që një bashkëpunim i tillë të vazhdojë edhe në të ardhmen me qëllim të ofrimit të një ambienti sa më të sigurt për qytetarët.

Nga ana tjetër, Komandanti i Komandës Regjionale – Lindje të KFOR-it Amerikan në Kampin “Bondsteel”, Major Kevin Dugas, ka përgëzuar Kryetarin Imri Ahmeti për punën dhe ka vlerësuar lart kontributin e tij në shërbim të qytetarëve, por në të njëjtën kohë ka ofruar edhe gatishmërinë e bashkëpunimit në realizimin e disa projekteve me rëndësi për qytetarët e Lipjanit.

Në fund të takimit, Kryetari Imri Ahmeti dhe Major Kevin Dugas, në shenjë respekti dhe mirënjohje për bashkëpunimin e ndërsjellë, kanë shkëmbyer stemën e Komunës së Lipjanit dhe një simbol nga KFOR-i Amerikan – Brigada e Kombësisë.

Komiteti për Komunitete ka zhvilluar punimet e mbledhjes së 42-të me radhë



Në sallën e takimeve të Komunës së Lipjanit, u mbajt mbledhja e 42-të e Komitetit për Komunitete (KK), e udhëhequr nga kryesuesi, z. Skender Bikliqi, ku u shqyrtuan të gjitha pikat e rendit të ditës.

Gjatë takimit, zyrtari nga Drejtoria e Arsimit ka dhënë një informatë lidhur me fillimin e procesit mësimor 2025-2026.

Në përfundim të mbledhjes, anëtarët e Komitetit shqyrtuan disa çështje dhe kërkesa të ndryshme të pranuar nga komunitetet.

Panairi i Produkteve Bujqësore



Komuna e Lipjanit, në bashkëpunim me organizatën IADK, organizoi panairin e produkteve bujqësore, me qëllim promovimin dhe zhvillimin e sektorit bujqësor dhe përpunimin e produkteve ushqimore.

Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, gjatë vizitës së tij falënderoi organizatën IADK për mbështetjen e vazhdueshme dhe bashkëpunimin e deritanishëm. Ai theksoi se ky panair është një mundësi e rëndësishme për promovimin e produkteve bujqësore dhe për të mbështetur prodhuesit vendor, duke i inkurajuar ata për zhvillimin e qëndrueshëm të veprimtarisë së tyre.

Panairi pasqyron përkushtimin e Komunës së Lipjanit për nxitjen e ekonomisë lokale dhe promovimin e produkteve bujqësore, duke krijuar mundësi të reja për zhvillimin e qëndrueshëm të prodhuesve vendorë.

Nënkryetari Bytyqi merr pjesë në hapjen e biznesit “Rina Dessert” në Lipjan



Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, z. Diamant Bytyqi, mori pjesë në hapjen e biznesit të ri “Rina Dessert” në qytetin e Lipjanit. Ky biznes është mbështetur nga Komuna e Lipjanit në bashkëpunim me organizatat IADK dhe FRIeDA.

Me këtë rast, nënkryetari Bytyqi u shpreh i lumtur për hapjen e bizneseve të reja në qytet, veçanërisht kur ato ndërmerren nga gratë. Ai theksoi se përfshirja e grave në sipërmarrje është dëshmi e aftësive dhe përkushtimit të tyre, sa më shumë gra të angazhohen në biznes, aq më shumë do të rriten punësimi dhe zhvillimi ekonomik në komunën tonë.

Komuna e Lipjanit do të vazhdojë të mbështesë iniciativat që fuqizojnë ekonominë lokale dhe krijojnë mundësi të reja për qytetarët.



Komuna e Lipjanit mirëpret delegacionin nga Shqipëria



Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, z. Diamant Bytyqi, priti në takim një delegacion nga Shqipëria, në kuadër të vizitës së shkëmbimit të përvojave për barazinë gjinore dhe qeverisjen lokale me ndjeshmëri gjinore.

Me këtë rast, nënkryetari Bytyqi theksoi përkushtimin e Komunës së Lipjanit për avancimin e politikave gjithëpërfshirëse.

“Komuna e Lipjanit mbetet e përkushtuar në fuqizimin e grave dhe avancimin e barazisë gjinore në jetën publike dhe vendimmarrëse. Jemi ndër 17 komunitet në Kosovë që kanë miratuar tashmë Planin Lokal të Veprimit për Barazinë Gjinore, proces i mbështetur nga projekti ‘Instrumenti për Barazi Gjinore’, i financuar nga Bashkimi Evropian në Kosovë dhe i zbatuar nga zyra e UN Women në Kosovë”, tha nënkryetari z. Diamant Bytyqi.

Ai shtoi se këto takime janë platforma të rëndësishme për shkëmbimin e praktikave të mira me institucionet e rajonit, duke ndihmuar në forcimin e kapaciteteve për një qeverisje vendore më transparente dhe gjithëpërfshirëse.

Delegacioni nga Shqipëria përfshinte përfaqësues të institucioneve qendrore dhe vendore, si Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale, Ministria e Shtetit për Pushtetin Vendor, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, si dhe bashkitë Tiranë, Elbasan, Roskovec, Lushnjë, Lezhë, Maliq, Kamëz, Divjakë, Dibër dhe Malësi e Madhe. Pjesë e takimit ishin edhe ekipet e projekteve të UN Women nga Shqipëria dhe Kosova.

Ky takim forcon bashkëpunimin drejt rritjes së shkëmbimit të përvojave mes institucioneve të të dyja vendeve dhe zhvillimin e politikave vendore më gjithëpërfshirëse.

Nderohet me homazhe dëshmori i Kombit, Arsim Zeqiri



Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët, kanë bërë homazhe dhe ka vendosur buqeta me lule pranë shtatores së Heroit të Kombit, Arsim Zeqiri, në fshatin Hallaq i Madh, me rastin e 27-vjetorit të rënies së tij.

Kryetari Ahmeti theksoi se jo vetëm familja, por i gjithë Lipjani është krenar për heroin Arsim Zeqiri, i cili në moshë të re iu bashkua UÇK-së për të mbrojtur vendin dhe popullin e tij. Sot duhet të jemi krenarë që patëm djem të tillë si Arsim Zeqiri, ndërsa obligimi ynë mbetet të punojmë me ndershmëri për atdheun, sepse vetëm kështu i nderojmë të rënë tanë.

Komuna e Lipjanit pjesë e projektit për mbështetjen e të rinjve ndërmarrës



Komuna e Lipjanit, në bashkëpunim me Islamic Relief Kosova, e cila organizoi ceremoninë e ndarjes së granteve për biznese start-up, si pjesë e projektit për edukim dhe ndërmarrësi, të organizuar dhe udhëhequr nga Islamic Relief Kosova.

Ky projekt ka për qëllim rritjen e mundësive për të rinjtë ndërmarrës të komunës sonë.

Në ceremoni mori pjesë Drejtori për Ekonomi dhe Zhvillim në Komunën e Lipjanit, z. Valon Pacolli, i cili theksoi rëndësinë e kësaj mbështetjeje për të rinjtë dhe për zhvillimin ekonomik lokal, si dhe shprehu gatishmërinë e Komunës për bashkëpunime të ngjashme edhe në të ardhmen.

Nga gjithsej 71 të rinj që ndoqën trajnimin mbi Planin e Biznesit dhe Ndërmarrësinë, u përzgjedhën 12 ide biznesore më premtuese, të cilat do të mbështeten për të nisur aktivitetin e tyre.

Ndërsa drejtori i organizatës Islamic Relief Kosova, Dr. Mohamed Soliman, falënderoi Komunën e Lipjanit për bashkëpunimin e vazhdueshëm.

Ky projekt u mbështet nga Islamic Relief Deutschland dhe synon fuqizimin ekonomik të të rinjve, si dhe krijimin e mundësive të reja për vetëpunësim në Kosovë.

Kryetari Ahmeti priti në takim Rejan Krasniqin, kampion në garat ndërkombëtare në Zvicër



Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, ka pritur në takim nxënësin e SHFMU “Vëllezërit Frashëri”, Rejan Krasniqi, fitues në Garat e 14-ta Ndërkombëtare të Abakusit dhe Aritmetikës Mentale, të organizuara nga Brainobrain International, të mbajtura në Kloten, Zürich të Zvicrës.

Me këtë rast, Kryetari Ahmeti e uroi Rejanin për suksesin e arritur, duke i dëshiruar edhe shumë arritje të tjera në të ardhmen.

“Ndjehem jashtëzakonisht krenar për sukseset e nxënësve tanë, të cilët në çdo garë ku marrin pjesë po shpallen kampionë. Këto arritje na bëjnë të gjithëve krenarë dhe janë dëshmi e talentit dhe përkushtimit të fëmijëve të Lipjanit,” tha Kryetari z. Imri Ahmeti.

Rejani ka treguar shkathtësi të jashtëzakonshme, duke u shpallur kampion i garës dhe duke u nderuar me medalje të artë.

Në shenjë mirënjohjeje për përfaqësimin dinjitoz të Kosovës dhe të Lipjanit, Kryetari Ahmeti i dhuroi pllaketën e Komunës së Lipjanit.





Komuna e Lipjanit – Zyra për informim



<https://lipjan.rks-gov.net/>



infokomuna.lipjan@rks-gov.net



0 800 14 000 / 038 200 41 508